



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

VENDIM

Nr. 25, datë 13.07.2020

MBI

“ZBATIMIN E VKM-SË 778, PËR PËRFITIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave “për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”; si dhe në shkresat e Fakulteteve të UART dhe pasi e diskutoi, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Studentët të cilët përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit, sipas përcaktimeve të VKM-778, duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik mbi bazë të të cilit llogaritet nota mesatare vjetore, e cila nuk duhet të jetë nën 6 (gjashtë).
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratorja dhe Fakultetet e Universitetit të Arteve.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Risena Xhaja (Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Arben BASHA (Anëtar)




Aida Martiro (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)



Lorenc Vangjeli (Anëtar)



Vladimir Llakaj (Anëtar)

